



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.9, datë 5.2.2007

**PËR  
MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROJEKTIT “SWEB”  
(SHËRBIME MOBILE TË SIGURTA, NDËRVEPRUESE DHE NDËRKUFITARE, TË  
CILAT KONTRIBUOJNË PËR NJË BASHKËPUNIM EUROPIAN TË BESUESHËM  
ME VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR JO ANËTARË TË BE)  
FINANCUAR ME GRANT NGA KOMISIONI EUROPIAN**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin Nr.8871, datë 29.3.2002, ligjit Nr.7776, datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, ndryshuar me ligjin Nr.8399, datë 9.9.1998, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë projektin “SWEB” (Shërbime Mobile të Sigurta, ndërvepruese dhe ndërkufitare, të cilat kontribuojnë për një bashkëpunim evropian të besueshëm me vendet e Ballkanit Perëndimor jo anëtarë të BE), të përfituar nga Bashkia e Tiranës dhe financuar me grant nga Komisioni Evropian në shumën 60.749 euro.
2. Të përfshijë këtë shumë në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2007 si të ardhur dhe shpenzime sipas përcaktimit të donatorit në projekt (aneksi 1).
3. Të ngarkojë Njësinë e Përgatitjes dhe Koordinimit të Projekteve për organizimin e punës mbi zbatimin e projektit.
4. Të ngarkojë strukturat përkatëse të Bashkisë së Tiranës për kryerjen e procedurave organizative dhe financiare mbi likuidimin e shpenzimeve.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**